



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA**  
**NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**

---

**KPM 2012/02**

Në mbështetje të nenit 3.2.6 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligjit për KPM-n), KPM nxjerr:

## **RREGULLORE PËR TË DREJTËN E AUTORIT**

### **Neni 1** **QËLLIMI**

Kjo rregullore ka për qëllim respektimin dhe mbrojtjen e së drejtës së transmetimit dhe ritransmetimit në pajtim me obligimet që dalin nga e drejta e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta në pajtim me praktikën ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale duke përfshirë, shërbyesit medial audio-vizual. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtës së autorit është faktor vendimtar për zhvillimin e konkurrencës së rregullt dhe të drejtë në tregun medial.

### **Neni 2** **FUSHËVEPRIMI**

1. Me këtë Rregullore, përcaktohen kriteret për shërbimet mediale audio-vizuele për të vepruar në pajtim me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe praktikatat evropiane të pranuar.
2. Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Transmetim obligojnë shërbimet mediale audio-vizuele që të veprojnë në pajtueshmëri me Ligjin për të Drejtën e Autorit.
3. Për të vlerësuar pajtueshmërinë me Ligjin për të Drejtën e Autorit, KPM kërkon prej subjekteve që ofrojnë shërbime mediale audio-vizuele sigurimin e provave, marrëveshjeve të vlefshme për transmetimin e veprave me të drejtë autoriale.

### **Neni 3** **PËRKUFIZIMET**

1. **E drejta e autorit** është e drejtë e pandashme e një vepre, e cila i takon autorit si subjekt i pronës intelektuale për veprën e mbrojtur .
2. **Autor** është personi fizik i cili e ka krijuar veprën.

3. **Veprat audio-vizuele** - janë: filmat kinematografikë, televizivë dhe vizatimorë, filmat e shkurtër video muzikor, filmat reklamues, filmat dokumentarë si dhe veprat tjera audio-vizuele, të shprehura në formë të vargut të pamjeve lëvizëse të ndërlidhura, të shoqëruara me zë apo pa të, pavarësisht nga lloji i mbajtësit lëndor ku janë të fiksuara.
4. **Ofrues i shërbimit medial** - personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audio-vizuele të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
5. **Shoqata kolektive**- ka kuptimin e asociacionit të formuar në pajtim me dispozitat e kreut III të Ligjit për të Drejtat e Autorit, në mënyrë që të zbatojë detyrat dhe aktivitetet e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit apo të drejtave të përafërta.
6. **Publikim** - kur një vepër e mbrojtur me të drejta të autorit apo me të drejta të përafërta i është vënë në dispozicion publikut me pëlqimin e bartësit të të drejtës.

#### **Neni 4**

#### **DETYRIMET PËR TË DREJTËN E AUTORIT**

1. Të Licencuarit i kërkohet të veprojë në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta 04/L-065 si dhe ligjet tjera në zbatim në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë marrëveshje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që rrjedhin nga sateliti. Në rastin kur programi konsiderohet i zotërimit publik, prodhimi i të cilit është më i vjetër se 70 vjet, nuk kërkohet një leje e tillë.
2. I Licencuari obligohet që t'i sigurojë KPM-së kopje të marrëveshjeve për këto të drejta brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i kërkesës me shkrim.

#### **Neni 5**

#### **TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO-VIZUELE**

1. Çdo shërbim medial audio-vizuel ka përgjegjësi për të garantuar se përmbajtja e të gjitha programeve të transmetuara dhe ritransmetuara është në përputhje me Ligjin për KPM-në, Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, dhe me këtë Rregullore.
2. Mediat audio-vizuele duhet ta ndërpresë menjëherë transmetimin apo ritransmetimin e mëtutjeshëm të përmbajtjes ilegale, edhe pse ai ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme të kujdesit, dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e këtillë nuk do të përsëritet.

3. Shërbimet mediale audio-vizuele pavarësisht teknologjisë së përdorur për ofrimin e përmbajtjes audio-vizuele, obligohen të bëjnë transmetimin dhe ritransmetimin e programeve bazuar në marrëveshjet e vlefshme për të drejtën e autorit.
4. Shërbimet mediale audio-vizuele janë të obliguara që transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audio-vizuele ta bëjnë vetëm pasi ato të hynë në marrëveshje me shoqatat kolektive për administrim kolektiv të të drejtave, të cilat licencohen nga Zyra për të drejtën e autorit pranë Ministrisë së Kulturës, në pajtim me nenin 171 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta Nr. 04/L-065.

## **Neni 6**

### **E DREJTA E INFORMIMIT PUBLIK**

#### **1. E drejta për raporte të shkurtra të lajmeve**

- 1.1. Me qëllim të raporteve të lajmeve të shkurtra, çdo transmetues televiziv dhe/apo radio i themeluar në Republikën e Kosovës ka qasje me kushte të barabarta për ngjarjet me interes të lartë për publikun të cilat janë transmetuar në baza ekskluzive nga një transmetues televiziv dhe apo/radio sipas juridiksionit të Republikës së Kosovës.
- 1.2. Nëse një transmetues televiziv dhe/apo radio i themeluar në Republikën e Kosovës ka fituar të drejtat ekskluzive për ngjarjet me interes të lartë për publikun, transmetuesi tjetër televiziv dhe/apo radio i themeluar në Republikën e Kosovës mund të kërkojë qasje për ngjarjen e përmendur nga ai transmetues televiziv dhe/apo radio. Të gjithë transmetuesit televiziv dhe/apo radio kanë të drejtën për qasje në ngjarjet me interes të lartë për publikun sipas kushteve të barabarta.
- 1.3. Komisioni i Pavarur për Media do të sigurojë që qasja për ngjarjet e referuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni garantohet duke lejuar transmetuesin televiziv dhe/apo radio për të zgjedhur lirisht ekstrakte të shkurtra nga sinjali i emtuar i transmetuesit televiziv dhe/apo radio të paktën me identifikim të burimit të tyre, përveç nëse është e pamundur për arsye praktike.
- 1.4. Transmetuesi televiziv dhe/apo radio, para dhe në vend të qasjes në sinjal brenda kuptimit të paragrafit 3 të këtij neni, mund të kryej qasje në ngjarjet e referuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni me qëllim të transmetimit të ekstrakteve të shkurtra apo përdorimin e materialit të regjistruar të një transmetuesi televiziv dhe/apo radio i cili ka të drejtat ekskluzive për transmetimin e ngjarjeve të interesit të lartë për publikun.
- 1.5. Ekstraktet e shkurtra do të përdoren vetëm për programet kryesore të lajmeve dhe mund të përdoren në shërbimet mediale audio-vizuele me kërkesë (on-demand) vetëm nëse programi i njëjtë ofrohet në një kriter të shtyrjes së afatit nga ofruesi i njëjtë i shërbimeve mediale.

- 1.6. Informacioni i shkurtër, sipas këtij neni, nënkupton njoftimin i cili zgjat 90 sekonda më së shumti dhe i cili është i paraqitur si pjesë e programit informativ.
- 1.7. Transmetuesi televiziv dhe/apo radio që transmeton ngjarjen me interes të lartë për publikun ka të drejtë të kërkojë nga transmetuesi tjetër televiziv dhe/apo radio kompensim të shpenzimeve aktuale që kryhen në përmbushjen e obligimeve të tij. Kompensimet e parashikuara nuk duhet të tejkalojnë kostot shtesë të shkaktuara drejtpërdrejt duke lejuar qasje.
- 1.8. E drejta për raporte të shkurtra të lajmeve do të zbatohet në atë mënyrë që nuk do të pengon rrjedhjen e ngjarjeve.
- 1.9. Nëse një ngjarje me interes të lartë për publikun përbëhet nga disa element të organizuar vet-përbërës, çdo element vet-përbërës konsiderohet të jetë një ngjarje me interes të lartë për publikun.
- 1.10. Nëse një ngjarje me interes të lartë për publikun zhvillohet gjatë dy apo më shumë ditëve, transmetuesi televiziv dhe/apo radio ka të drejtën për të prodhuar një raport të shkurtër të lajmeve për secilën ditë.
- 1.11. Transmetuesi televiziv dhe/apo radio, i cili ka përdorur të drejtën për raporte të shkurtra të lajmeve do t'i mundësojë transmetuesit televiziv dhe/apo radio i cili nuk ka mundur të regjistrojë ngjarjen një përdorim të vetëm të regjistrimit dhe do të ketë të drejtën për të kërkuar kompensim për këtë, në proporcion me pjesët e kostos aktuale, si dhe përdorimin e emrit të tij apo emrin e kompanisë në njoftim.
- 1.12. Standardi i “përdorimit të drejtë” nuk do të interpretohet për të lejuar përdorim të shumëfishtë, përdorim të vazhdueshëm të materialit të lajmeve të prodhuara nga organizatat tjera në mungesë të një marrëveshjeje të vlefshme nga pronarët e të drejtave të autorit të materialit të tillë apo nga agjentët e autorizuar të tyre. Në asnjë rast, një “përdorim i drejtë” nuk do të rrezikojë interesat ekonomike dhe morale të pronarëve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

## **2. E drejta e publikut për të ndjekur ngjarjet të rëndësishme të madhe për shoqërinë**

- 2.1. Transmetuesi televiziv nuk duhet, në baza ekskluzive, të transmetojë ngjarje që konsiderohen si të një rëndësie të madhe për shoqërinë në atë mënyrë që mund të privojë një pjesë të konsiderueshme të publikut në Republikën e Kosovës nga mundësia e ndjekjes së ngjarjeve të tilla në mbulim të drejtpërdrejt apo mbulim të shtyrë (mëvonshëm) në televizionet pa pagesë.

- 2.2. KPM do të hartojë një listë të ngjarjeve të caktuara të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, nacionale ose jo-nacionale, të cilat i konsideron të jenë të një rëndësie të madhe për shoqërinë dhe gjithashtu do të përcakton nëse këto ngjarje do të jenë në dispozicion nga mbulimi i drejtpërdrejt i plotë apo i pjesërishëm, ose kur është e nevojshme apo e përshtatshme për arsye objektive në interesin publik, mbulim i shtyrë/mëvonshëm i plotë apo i pjesërishëm.
- 2.3. Është në kundërshtim me këtë Rregullore nëse ngjarja e referuar në paragrafin 1 të këtij neni transmetohet në bazë të të drejtave ekskluzive të marra nga një transmetues televiziv, programi audio-vizuel i të cilit mund të shikohet nga më pak se 60% e popullsisë së Republikës së Kosovës apo nëse për të parë atë program kërkohen pagesa shtesë (TV me pagesë).
- 2.4. Me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë me Ligjin për të Drejtat e Autorit, kjo Rregullore përcakton kërkesat operative të mëposhtme për transmetuesit e licencuar nga KPM-ja.
- 2.5. Kjo Rregullore nuk duhet të shihet si një interpretim i plotë i asaj që është e lejuar ose nuk është e lejuar sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të autorit.

#### **Neni 7**

### **TRANSMETIMI I PJESËVE SUBSTANCIALE OSE TËRËSISË SË MATERIALIT ME TË DREJTA AUTORIALE**

Transmetimi i tërësishëm apo i pjesëve të konsiderueshme të materialeve në video, audio ose tekstuale që janë objekt i mbrojtjes së autorit, duke tejkaluar standardet e Informimit të Publikut të përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje, lejohet vetëm në kuadrin e një kontrate të vlefshme me pronarin e të drejtave të autorit ose me shitësin e autorizuar ligjërisht për materiale të tilla.

#### **Neni 8**

### **SANKSIONET**

Për mosrespektim të kësaj rregulloreje do të aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

#### **Neni 9**

### **DISPOZITAT KALIMTARE**

Më këtë Rregullore shfuqizohet Rregullorja CIMC 2009/03 për Pajtueshmërinë me obligimet e të drejtës së Autorit.

**Neni 10**  
**HYRJA NË FUQI**

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM).

---

Shefki Ukaj  
Kryetari i Komisionit të Pavarur të Mediave

---

Datë